

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	---	---

S T A T U T I

I

KOMUNËS SË PRISHTINËS

Prishtinë

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, pika 12.2, shkronja a dhe pika 12. 3 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.2.2010, miratoi

S T A T U T I N

E

KOMUNËS SË PRISHTINËS

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Neni 1

1.1 Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës, që miratohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

1.2 Statuti është bazë për sigurimin e zbatimit të kompetencave dhe përgjegjësiive e të Komunës, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjet tjera.

1.3 Statuti rregullon kompetencat dhe pushtetin e Komunës, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në mbledhje, aktivitetet dhe mënyrën e vendosjes në punët publike, organet e Komunës dhe Shërbimin civil, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit, administrimin financiar dhe konfliktin e interesave.

Neni 2

Komuna është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale (në tekstin në vazhdim: LVL), ligjet tjera në fuqi dhe Statutin e Komunës.

Neni 3

3.1 Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme "Komuna"), ka emblemën dhe simbolet, të cilat përdoren brenda territorit të saj në pajtim me Ligjin për simbolet shtetërore.

3.2 Simbolet e Komunës miratohen dhe ndryshohen nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

3.3 Simbolet e Komunës miratohen apo ndryshohen me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës.

3.4 Asnjë person, përveç Komunës, nuk ka të drejtë ta përdorë emblemën dhe simbolet e Komunës pa autorizim me shkrim nga Kryetari i Komunës.

Neni 4

4.1 Komuna e ka statusin e personit juridik.

4.2 Komuna e ka të drejtën të padisë dhe mund të paditet në gjykatë, të jetë titullar i së drejtës pronësore, të posedojë dhe të menaxhojë pasurinë, të lidhë kontrata, të punësojë staf, të angazhohet në aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësiive të saj.

Neni 5

Selia e Komunës është në Prishtinë, rruga "UÇK", nr. 2.

Neni 6

6.1 Qyteti Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës.

6.2 Prishtina është kryeqendër administrative, politike, ekonomike, shëndetësore, arsimore, kulturore dhe të tjera të parapara me ligjet e Kosovës.

Neni 7

Territori dhe kufijtë e komunës janë përcaktuar me Ligjin për kufijtë administrativë të komunave.

Neni 8

Komunën e Prishtinës, si njësi territoriale, e përbëjnë qyteti i Prishtinës dhe fshatrat në vijim.

Hajkobillë	Marec
Hajvali	Matiçan
Ballaban	Mramor
Barilevë	Nishec
Besi	Novosellë
Busi	Orloviq
Dabishec	Nëntë Jugoviq
Prapashticë	Prugoc
Bërnice e Poshtme	Dragoc
Radashec	Drenoc
Rimanishtë	Glllogovicë
Sharban	Bërnice e Epërme
Shashkoc	Grashticë
Siqevë	Keqekollë
Slivovë	Kolovicë
Sofali	Koliq
Tenezhdoll	Kukavicë
Trudë	Lebanë
Vranidoll	LLukar
Zllatar	Makoc
Çagllavicë	

Neni 9

9.1 Kuvendi i Komunës, varësisht nga dispozitat e LVL - së dhe të Statutit të Komunës, mund të përcaktojë kompetenca të deleguara në lidhje me dispozitat e shërbimeve komunale në fshatra dhe lagje urbane.

9.2 Komiteti për Politikë dhe Financa i shqyrton dhe i propozon Kuvendit të Komunës një numër të caktuar të kompetencave të veçanta, të cilat mund të ushtrohen nga përfaqësuesit e fshatrave dhe të lagjeve urbane.

9.3 Gjatë secilit vit fiskal, Kuvendi mbikëqyrë zbatimin e kompetencave të deleguara në pajtim me Statutin.

9.4 Kompetencat e deleguara zbatohen në bazë të marrëveshjeve me shkrim, të cilat nuk mund të jenë në kohëzgjatje më të madhe sesa mandati i Kuvendit të Komunës. Marrëveshjet duhet të mbulojnë, në mes tjerash, (i) fondin, (ii) të ardhurat, (iii) shërbimet dhe (iv) administratën.

9.5 Menaxhimi i përbashkët për marrëveshjet e bëra në pajtim me dispozitat e këtij neni, zbatohet nga një këshill i përbashkët mbikëqyrës. Kuvendi i Komunës emëron anëtarët e këtyre këshillave për t'i prezantuar dhe mbrojtur interesat e Komunës.

Neni 10

10.1 Komuna ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit "vulat e Komunës".

a) Vula e rrumbullakët përmban tekstin:

- rrethi i parë: *Republika e Kosovës*;
- rrethi i dytë: *Komuna e Prishtinës*;
- rrethi i tretë: *Drejtoria e*

Në mes të vulës është emblema.

b) Vula e protokollit të Komunës ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë, me tekstin:

- *Republika e Kosovës*;
- *Komuna e Prishtinës*;
- ____. nr. _____, më _____;
- *Nr. i shtojcave*.

10.2 Vula e Komunës miratohet apo ndryshohet nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

10.3 Vulat e Komunës, të përshkruara në pikat a dhe b, tekstin e kanë në gjuhët në përdorim zyrtar.

10.4 Numrin, dimensionet, mënyrën e mbajtjes dhe të përdorimit të vulave të Komunës, e përcakton Kryetari i Komunës me vendim të veçantë.

Neni 11

Komuna e Prishtinës e ka festën e saj publike, më 11 qershor të çdo viti.

Neni 12

12.1 Kuvendi i Komunës ndan dhurata, shpërblime, dekorata, mirënjohje, falënderime dhe tituj.

12.2 Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë, përcakton kushtet dhe mënyrën e ndarjes së dhuratave, shpërblimeve, dekoratave, mirënjohjeve dhe titujve.

12.3 Dhuratat, në kundërvlerë në € dhe shpërblimet në të holla, nuk duhet të tejkalojnë shumën mbi 200 €, përveç në rastet kur Kuvendi i Komunës merr vendim për një shumë më të lartë.

Neni 13

13.1 Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre, në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të Komunës. Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehen në gjuhët e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.

13.2 Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të Këshillit të Drejtorëve dhe në të gjitha takimet publike, diskutimet mund të bëhen në të dy gjuhët: shqipe dhe serbe.

13.3 Të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës shtypen në të dy gjuhët: shqipe dhe serbe. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga Komuna, do të jepen në gjuhën e palës. Gjuhë e palës konsiderohet gjuha në të cilën pala fillimisht iu ka drejtuar Komunës.

13.4 Rregulloret komunale, si dhe aktet tjera, publikohen në gjuhët e komuniteteve të tjera, nëse atë e kërkojnë.

13.5 Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, janë në gjuhën shqipe dhe serbe.

13.6 Komunikimi me institucionet komunale, institucionet e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "IRK") dhe organet e organizatave tjera, mund të bëhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Gjuha turke dhe gjuha boshnjake mund të përdoren në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

13.7 Çështjen e përdorimit të gjuhëve, Kuvendi i Komunës do ta rregullojë me rregullore të veçantë.

Neni 14

Në organet dhe shërbimet publike të Komunës sigurohet përfaqësimi proporcional i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe strukturës gjinore.

KAPITULLI II

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Komunës.

Neni 15

Komuna i ushtron kompetencat vetjake dhe të deleguara në pajtim me LVL - në.

a) Kompetencat vetjake

15.1 Komuna ka kompetenca vetjake në këto fusha:

- a) Zhvillimin lokal ekonomik;
- b) Planifikimin urban dhe rural;
- c) Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit;
- e) Mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale;
- g) Përgjigjet për rastet emergjente lokale;
- h) Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- i) Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) Ofrimin e përkujdesjes publik parësor shëndetësor;
- k) Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç janë: përkujdesja ndaj të rrezikuarve socialë, strehimi familjar, përkujdesja ndaj fëmijëve, përkujdesja ndaj të moshuarve, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të përkujdesjes, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;

- l) Banimin publik;
- m) Shëndetësinë publike;
- n) Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin lokal publik dhe taksitë;
- o) Emërtimin e shesheve, rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- p) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- q) Turizmin;
- r) Aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive dhe aktivitet e lira;
- s) Çështje të tjera, të cilat, me ligj ose akte nënligjore, janë paraparë si kompetenca vetjake të Komunës.

b) Kompetencat e deleguara

15.2 Komuna ushtron kompetenca të deleguara nga autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës në pajtim me ligjin, në fushat në vijim:

- a) Shënimet kadastrorë;
- b) Regjistrimin civil;
- c) Regjistrimin e votuesve;
- d) Regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- e) Distribuirimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- f) Mbrojtjen e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drurëve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

15.3 Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'i delegojnë Komunës përgjegjësi shtesë, që janë në kuadër të kompetencave të tyre, me kusht që Komunës t'i sigurohen burimet financiare.

15.4 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbikëqyrë, nëse veprimet apo vendimet që i ndërmerr Komuna janë në përputhje me LVL - në.

Shtirja administrative në vendbanimet brenda territorit të komunës.

Neni 16

Komuna, me vendim të Kuvendit për vendbanimet e caktuara, mund të themelojë zyra për kryerjen e shërbimeve të caktuara nga kompetenca e organeve të administratës komunale.

Bashkëpunimi ndërkomunal

Neni 17

Komuna bashkëpunon dhe krijon partneritet me komunat tjera të Republikës së Kosovës, brenda kompetencave të saj, për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët.

KAPITULLI III

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në mbledhjet dhe në aktivitetet vendimmarrëse për çështjet me interes publik

Neni 18

Qytetarët, në pajtim me Statutin, në Komunë mund t'i iniciojnë për shqyrtim çështjet me interes publik, përmes:

- a) mënyrave të konsultimit,
- b) pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në takime dhe
- c) Përmes shkresave të shtruara me shkrim

Neni 19

19.1 Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të qytetarëve me karakter të përgjithshëm apo të veçantë, për kategori të caktuara të banorëve të qytetit, të fshatrave apo të lagjeve urbane, Komuna organizon:

- a) Fushata informative dhe publikime për promovimin e programeve dhe të aktiviteteve komunale;
- b) Kontakte me qarqe të zgjedhura për të diskutuar politikat;
- c) Anketa lidhur me zbatimin e politikave;
- d) Prezantime publike të propozimeve lidhur me politika apo projektregullore, duke ftuar për pjesëmarrje;
- e) Kontakte me grupet përkatëse të interesit;
- f) Takime me qytetarë;
- g) Seanca publike;
- h) Shqyrtime publike;
- i) Studime për vlerësimin e ndikimit;
- j) Komitete këshillëdhënëse dhe
- k) Referendum.

19.2 Arsyetimi për zgjedhjen e formave, apo të pjesëmarrjes publike, do të jepet në çdo rast dhe do të lejohet një afat kohor i mjaftueshëm për paraqitjen e prezantimeve.

19.3 Rezultatet e konsultimeve apo të pjesëmarrjes, do të merren parasysh dhe do të publikohen para se të merret vendimi përfundimtar.

Neni 20

Para miratimit të rregulloreve komunale, Komuna praktikon mënyrë të gjerë të konsultave paraprake publike, duke ofruar informata të nevojshme për opinion - qytetarë të interesuar, përmes formave si vijon:

- a) Fushatës informative për ngritjen e vetëdijesimit për propozime;
- b) Kontaktit me grupet e interesit dhe palët e interesuara për t'i testuar dhe diskutuar propozimet;
- c) Shpalljes publike të propozimeve;
- d) Ftesave për përfaqësuesit dhe lejimin e së paku katërmëbëdhjetë ditëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre dhe
- e) Studimeve për vlerësimin e ndikimit.

Neni 21

- 21.1 Komuna organizon takime publike periodike me qytetarë, së paku dy herë në vit.
- 21.2 Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale;
- 21.3 Takimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.
- 21.4 Takimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
- 21.5 Pjesëmarrësit në këto takime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.
- 21.6 Njëri takim duhet të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë.
- 21.7 Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy takime me qytetarë, atëherë ndërmjet këtyre takimeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku tre muajsh.
- 21.8 Takimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.

Neni 22

Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë, shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtes/ën-at e Komunës dhe në vendet më frekuentuese në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës, 4 ditë para mbajtjes së takimit. Shpalljen publike e bën Zyra për marrëdhënie me publikun.

Neni 23

- 23.1 Takimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës, apo përfaqësuesi i tij.
- 23.2 Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevojë, ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit, të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.
- 23.3 Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë takimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së takimit.

Neni 24

- 24.1 Për çdo takim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.
- 24.2 Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së takimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në takim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për takim e ardhshëm.

Neni 25

- 25.1 Secili qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetiniciativë, përmes formës së petitionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështje të rëndësishme për qytetin, fshatin dhe lagjen urbane, në pajtim me LVL-në dhe Statutin e Komunës.

25.2 Subjektet e përmendur më lart mund t'i drejtojnë petition Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:

- a) rregullimin e qytetit,
- b) mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës/qytetit,
- c) urbanizimin e qytetit dhe të fshatit,
- d) mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,
- e) zbatimin e vetëkontrollit dhe
- f) çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

25.3 Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të petitionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes zyrës së drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

25.4 Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.

25.5 Kur një petition nënshkruhet nga më shumë se 3000 qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjë me çështjet që janë të lidhura me komunën, Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë çështjen. Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatra apo lagje të caktuara, peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës, nëse atë e nënshkruajnë së paku 500 qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, banorë të atij fshati apo të asaj lagje.

25.6 Nëse një fshat, vendbanim apo lagje ka më pak se 4 500 banorë të regjistruar në listat e votuesve, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë 51% të banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve.

25.7 Çdo petition duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e petitionit. Lënda e petitionit duhet të ceket qartë në secilën faqe. Komunitetet mund t'i bëjnë peticione Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e petitionit duhet të jetë ashtu siç është cekur më lart. Një petition, i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

Neni 26

26.1 Drejtori i Drejtorisë së Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita që ai e pranon çdo petition të vlefshëm, ia prezanton Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar apo Kuvendit. Përfaqësuesit e parashtruesve të petitionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të petitionit.

26.2 Vendimin përfundimtar për çështjen e petitionit e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 6 (gjashtë) javësh nga dita e prezantimit të petitionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet parashtrues/it-ve të petitionit.

Referendumi

Neni 27

27.1 Për çështjet e rëndësisë së veçantë, Komuna organizon referendum.

27.2 Organizimi i referendumit bëhet në përputhje me ligjit përkatës.

KAPITULLI IV

Organet e Komunës

Neni 28

Organet e Komunës janë: Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

Kuvendi i Komunës

Neni 29

29.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i Komunës, i cili ushtron funksionin e pushtetit lokal, të përcaktuar me LVL – në dhe Statutin e Komunës.

29.2 Kuvendi i Komunës ka 51 anëtarë.

29.3 Përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës duhet të ushtrohen nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës, përveç nëse parashihet ndryshe me LVL-në, ligjet tjera dhe Statutin e Komunës.

29.4 Kuvendi zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për zgjedhjet lokale.

29.5 Anëtarët e Kuvendit kanë të drejta të njëjta dhe mundësi për të marrë pjesë në proceset e Kuvendit.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit

Neni 30

30.1 Kuvendi i Komunës e miraton Statutin. Kuvendi i Komunës mund ta ndryshojë Statutin, nëse konsideron se një ndryshim i tillë është i nevojshëm. Çdo vendim për miratimin apo për ndryshimin e Statutit, duhet të miratohet nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit.

30.2 Kuvendi i Komunës e miraton Rregulloren e punës.

Neni 31

31.1 Nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit, mund të merret: (i) nga Kryetari i Komunës, (ii) nga 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe (iii) me iniciativën e 10 % të banorëve me të drejtë vote në komunë.

31.2 Propozimi për ndryshim dhe plotësim duhet të shqyrtohet nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa, pastaj i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim preliminar. Nëse Kuvendi nuk e refuzon propozimin, atëherë Kuvendi merr vendim për ta lëshuar në diskutim publik.

31.3 Pas përfundimit të diskutimit publik, Kuvendi i Komunës vendos se a do t'i miratojë ndryshimet dhe plotësimet, pasi t'i shqyrtojë të gjitha propozimet që i ka pranuar.

31.4 Rregullorja e punës mund të përcaktojë më tej procedurat për plotësimin e Statutit.

Neni 32

Procedurat për miratimin, ndryshimin apo anulimin e rregulloreve komunale, duhet të jenë si në vijim:

a) Kryetari i Komunës, në pajtim me LVL – në dhe me këtë Statut, propozon miratimin e rregulloreve komunale lidhur me çështjet në suaza të autorizimeve komunale, siç është

paraparë me LVL - në, dhe ia dërgon për shqyrtim kryesuesit të Kuvendit si kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.

b) Miratimin e një rregulloreje komunale mund ta propozojnë së paku shtatë anëtarë të Kuvendit. Propozimet e tilla duhet adresuar kryesuesit të Kuvendit, i cili duhet ta përfshijë si pikë të rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjet e radhës të komiteteve përkatëse komunale. Pas shqyrtimit nga komitetet përkatëse komunale, kryesuesi duhet t'i përcjellë propozimet Komitetit për Politikë dhe Financa, i cili do të shqyrtojë dhe propozojë atë, me apo pa ndryshime, për t'u miratuar nga Kuvendi i Komunës.

c) Kuvendi i Komunës do ta shqyrtojë projektin e rregullores së propozuar dhe, me ose pa plotësime, do ta miratojë atë për diskutim publik në pajtim me rregullat e punës së Kuvendit.

d) Të gjitha vërejtjet e pranuar nga opinioni publik duhet të shqyrtohen nga komisioni i caktuar nga propozuesi i rregullores. Komisioni duhet të përgatisë një raport me vërejtjet e pranuar, i cili duhet t'i dorëzohet për miratim Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës.

e) Rregullorja e Komunës, e miratuar nga Kuvendi i Komunës, publikohet në tabelën e shpalljeve në ndërtesat e Kuvendit të Komunës, si dhe në ueb - faqen e Komunës.

PËRGJEGJËSITË E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kompetencat dhe përgjegjësitë

Neni 33

33.1 Kuvendi i Komunës ka përgjegjësi për fushat në vijim:

- a) Miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e Statutit, Rregullores së punës dhe rregulloreve komunale,
- b) Miratimin e buxhetit dhe të planeve investuese;
- c) Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- d) Raportin vjetor;
- e) Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- f) Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete dhe nënkryetarit për komunitete;
- g) Nivelin e taksave, tarifave dhe gjobave komunale;
- h) Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- i) Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- j) Arritjen dhe miratimin e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- k) Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës dhe përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

33.2 Si shtesë në listën e përgjegjësi të padelegueshme të marra nga LVL - ja, e cila paraqitet më lart, çështjet në vijim mbeten në kompetencë të Kuvendit të Komunës dhe nuk mund të delegohen:

- a) Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës.
- b) Miratimi i :

- Planit zhvillimor komunal (PZHK),
- Planit zhvillimor urban (PZHU),
- Planit rregullues urban (PRRU), dhe ndryshimi i tyre.

Aktet e Kuvendit të Komunës

Neni 34

34.1 Kuvendi i Komunës miraton akte brenda kompetencave të tij, në pajtim me dispozitat e LVL - së. Këto akte përfshijnë:

- a) Statutin e Komunës,
- b) Rregulloren e punës,
- c) Rregulloret komunale dhe
- d) Çdo akt tjetër të nevojshëm, apo të duhur për funksionim efikas të Komunës.

34.2 Aktet e Kuvendit hyjnë në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në tabelën e shpalljeve të Komunës.

Mbledhja e parë dhe betimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Neni 35

35.1 Kuvendi i Komunës mban mbledhjen e parë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e certifikimit të rezultateve zgjedhore. Anëtari më i moshuar i Kuvendit i kryeson mbledhjet, derisa të zgjidhet kryesuesi.

35.2 Anëtarët e Kuvendit të Komunës e bëjnë betimin dhe atë e nënshkruajnë.

Përmbajtja e betimit është si vijon:

“Unë _____, betohem se do t’i kryej detyrat me nder, me besnikëri, pa anime, me ndërgjegje dhe sipas ligjit, dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.”

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe zëvendëskryesuesi për komunitete

Neni 36

36.1 Kuvendi i Komunës e zgjedh kryesuesin e Kuvendit të Komunës nga radhët anëtarëve. Mandati dhe procedurat e votimit janë të parapara me dispozitat e nenit 41 të LVL - së. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit. Mënyra e thirrjes dhe e udhëheqjes së mbledhjeve të Kuvendit rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit.

36.2 Rregullorja e punës përcakton se kush e thërret dhe e kryeson mbledhjen e Kuvendit të Komunës, nëse posti i kryesuesit është i paplotësuar, apo për çfarëdo arsye ai/a jo nuk merr pjesë në mbledhje.

36.3 Kuvendi i Komunës ka zëvendëskryesues për komunitete. Zëvendëskryesuesi zgjidhet nga radhët e anëtarëve të komuniteteve që përfaqësohen në Kuvend. Postin e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës joshumicë, i cili ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin e Komunës.

Kuorumi dhe mbledhjet

Neni 37

37.1 Kuorumi, për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, përbëhet nga më tepër se gjysma e anëtarëve, me përjashtim të rasteve kur për votim nevojiten 2/3 e anëtarëve të Kuvendit.

37.2 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve, secili anëtar ka të drejtë në një votë.

37.3 Kuvendi apo komitetet, në kuadër të kompetencave të tyre, me shumicë të votave, mund të vendosin që, për çështje të caktuara nga kompetenca e Komunës, votimi të jetë i mbyllur.

37.4 Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe propozimet e komiteteve të tij, merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, të cilët votojnë, përveç rasteve të caktuara ndryshe me Statutin e Komunës.

Neni 38

38.1 Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.

38.2 Kuvendi i Komunës mban mbledhje të jashtëzakonshme, nëse për këtë bëhet kërkesë me shkrim nga së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit, apo me kërkesë të Kryetarit të Komunës.

38.3 Mbledhjet e kërkuara nga anëtarët e Kuvendit, duhet të caktohen në pajtim me Rregulloren e punës. Kryetari, mund të kërkojë nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme për të diskutuar çështje urgjente, në çdo kohë brenda vitit. Mbledhjet e tilla, të jashtëzakonshme, duhet të thirren në pajtim me Rregulloren e punës. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjen e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

38.4 Kuvendi i Komunës, përmes zyrtarëve të Drejtorisë së Administratës, me shkrim njofton anëtarët e Kuvendit së paku 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit, kurse publiku, në pajtim me Rregulloren e punës, njoftohen përmes: (i) shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, (ii) medieve të shkruara dhe elektronike dhe (iii) ueb – faqes së Komunës.

38.5 Njoftimi me shkrim për anëtarët e Kuvendit dhe ai publik, duhet të përmbajë: (i) datën e mbajtjes së mbledhjes, (ii) kohën e mbajtjes së mbledhjes, (iii) vendin e mbajtjes së mbledhjes, (iv) rendin e ditës, (v) materialet e mbledhjes dhe (vi) të dhënat tjera.

Neni 39

39.1 Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, mbahet procesverbal. Procesverbal përfshinë emrat e anëtarëve të Kuvendit dhe të anëtarëve të tjerë të ftuar dhe të pranishëm, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret me emër secili anëtar, në procesverbal shënohet si ka votuar secili.

39.2 Procesverbalin e mban një shërbyes civil, i caktuar nga drejtori i Drejtorisë së Administratës.

39.3 Kryesuesi e nënshkruan procesverbalin e miratuar nga Kuvendi.

Konflikti i interesave të anëtarëve të Kuvendit

Neni 40

40.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës, apo anëtari i komitetit, nuk mund të jetë pjesëmarrës për marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative, të cilat kanë të bëjnë me cilëndo çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij, ka interes personal apo material.

40.2 Secili anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit, që lindin në cilëndo nga mbledhjet, në të cilat është i pranishëm. Secili anëtar duhet të ofrojë informacione, që janë në interes të anëtarit tjetër.

40.3 Secili anëtar duhet të tërhiqet vullnetarisht nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, kur konsideron se ato mund të çojnë deri te konflikti i interesave.

40.4 Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të punësohen në asnjë pozitë në Komunë, nëse më parë nuk kanë hequr dorë nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve.

40.5 Anëtarët e Kuvendit, para mbledhjes së parë të Kuvendit, në një deklaratë të plotë dhe të hapur, shënojnë interesat e tyre financiare dhe atë regjistër e mban drejtori i Drejtorisë së Administratës. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa të ndodhë.

Kompetencat plotësuese të anëtarëve të Kuvendit

Neni 41

Anëtari i Kuvendit të Komunës ka të drejtë:

- a) të kërkojë nga Kryetari i Komunës, kryesuesi i Kuvendit, kryesuesi i komunitetit ose Këshilli i Drejtorëve, informacione lidhur me çështjet komunale. Zyrtari, të cilit iu ka adresuar kërkesa, në afat prej 15 ditësh, duhet t'u përgjigjet me shkrim anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Një kopje e kërkesës dhe e përgjigjes duhet të futet në regjistër të drejtorit të Drejtorisë së Administratës, i cili duhet të shënojë datën e kërkesës së pranuar dhe datën e përgjigjes së dhënë;
- b) të dorëzojë me shkrim diskutimin e tij, i cili duhet t'i bashkëngjitet procesverbalit,
- c) të diskutojë, por nuk mund të votojë, në mbledhjet e komitetit në të cilin ai nuk është anëtar. Ai mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Neni 42

42.1 Punëdhënësit duhet t'u lejojë anëtarëve të Kuvendit që të mungojnë nga vendet e tyre të punës për periudhën e arsyeshme kohore që nevojitet për punën e Kuvendit.

42.2 Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës zbatojnë dispozitat e UA për kompensimin e anëtarëve të Kuvendit, duke përfshirë edhe anëtarët, të cilët mbajnë postin e kryesuesit dhe të zëvendëskryesuesit për komunitete, për punën e tyre në Kuvend dhe komitetit, me anë të kompensimit të shpenzimeve, humbjeve financiare ose një shumë paushall.

42.3 Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë, do të përcaktojë edhe kompensime të tjera për anëtarët e Kuvendit të Komunës: transport falas në transportin urban, shërbime shëndetësore në lëmin e shëndetësisë parësore, pjesëmarrje në ngjarjet sportive, kulturore dhe shërbime të ndryshme komunale.

Neni 43

43.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës, i cili nuk e nënshkruan tekstin e betimit brenda një muaji pas zgjedhjes, pushon të jetë anëtar i Kuvendit.

43.2 Anëtari i Kuvendit të Komunës, i cili është i dënuar me tre muaj burg për vepër penale të dënueshme dhe iu ka lëshuar urdhri për burgosje, pushon të jetë anëtar i Kuvendit.

43.3 Nëse anëtari i Kuvendit të Komunës nuk merr pjesë në mbledhje të Kuvendit ose në komitetet e tij gjashtë muaj rresht, ai pushon të jetë anëtar, përveç nëse ka munguar me arsye, të cilën e ka miratuar Kuvendi.

Komitetet

Neni 44

44.1 Kuvendi i Komunës formon 2 komitetet të përhershme:

- a) Komitetin për Politikë dhe Financa dhe
- b) Komitetin për Komunitete.

44.2 Kuvendi i Komunës formon edhe komitete të tjera, sipas nevojës.

44.3 Me rastin e emërimit të anëtarëve të komiteteve, duke përfshirë komitetet e përhershme, Kuvendi i Komunës duhet të bëjë përpjekje që të sigurojë një baraspeshë gjinore në të gjitha komitetet.

44.4 Komitetet tjera mund të kooptojnë në radhët e tyre individë që nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës, por shumica e anëtarëve të komiteteve duhet të jenë gjithnjë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

44.5 Përbërja e komiteteve duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e vendeve, që i mbajnë partitë politike dhe koalicionet në Kuvendin e Komunës.

44.6 Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i secilit komitet zgjidhet nga anëtarët e komitetit.

44.7 Kompetencat dhe aktivitetet e komiteteve tjera përcaktohen me Rregulloren për përbërjen dhe kompetencën e komiteteve.

44.8 Në mbledhjen e tyre të parë të çdo viti, komitetet duhet t'i caktojnë datat kur do të mbahen takimet e tyre të rregullta gjatë vitit. Datat mund të ndryshojnë varësisht nga ndonjë vendim tjetër. Mbledhjet plotësuese mund të thirren në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Neni 45

45.1 Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa emërohen vetëm nga anëtarët e Kuvendit të Komunës. Në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa mund të marrin pjesë edhe kryesuesit e komiteteve tjera të Kuvendit.

45.2 Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson Kryesuesi i Kuvendit, i cili duhet të vendosë edhe për çështjet të cilat duhet të shqyrtohen në këtë komitet. Kryesuesi, kur kryen detyrën e kryesuesit, ka të drejtën e votës vendimtare, nëse ka numër të barabartë të votave për dhe kundër propozimit.

45.3 Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe kompetencat e tij, janë të parapara me Rregulloren për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve.

Komiteti për Komunitete

Neni 46

46.1 Komiteti për Komunitetet themelohet nga Kuvendi i Komunës dhe në përbërjen e tij, përveç anëtarëve të Kuvendit, mund të përfshihen edhe përfaqësues të komuniteteve, të cilët nuk përfaqësohen në Kuvend, por janë banorë të komunës.

46.2 Komiteti për Komunitete promovon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe shqyrton drejt çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim, dhe bën rekomandimin e saj në Kuvendin e Komunës.

46.3 Gjatë themelimit të Komitetit për Komunitete, Kuvendi i Komunës duhet të sigurojë se është zbatuar procedura për emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve në përputhje me dispozitën e LVL - së.

Neni 47

Komiteti për Komunitete ka për detyrë që, në kuadër të Komunës, të sigurojë se:

- a) asnjë person, i cili merr përsipër detyra publike ose mban post publik, nuk guxon të bëjë diskriminim ndaj asnjë personi mbi kurrfarë baze, për shkak të përkatësisë etnike, gjuhës ose lidhjes me komunitetin;
- b) të gjithë qytetarët gëzojnë, në mënyrë të barabartë, të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi të barabartë për punësim në shërbimet komunale/të qytetit në të gjitha nivelet;
- c) shërbimi civil komunal/personeli pasqyron në proporcion të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

Komiteti konsultativ

Neni 48

48.1 Komiteti konsultativ themelohet nga Kuvendi i Komunës, pas propozimit të Kryetarit të Komunës, nga komitetet e përhershme dhe nga grupi i qytetarëve.

48.2 Kuvendi i Komunës mund të themelojë edhe komitete konsultative “Ad hoc” për çështje të caktuara. Mandati i tyre pushon pas përfundimit të çështjes.

48.3 Organizimi, kompetencat, anëtarësimi, mandati i anëtarëve dhe shkarkimi i anëtarëve, janë përcaktuar me Udhëzimin administrativ të ministrit të MAPL-së.

Komitetet tjera

Neni 49

49.1 Kuvendi i Komunës themelon edhe komitetet tjera:

1. Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
2. Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
3. Komitetin për Zhvillim Ekonomik dhe Rural;
4. Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
5. Komitetin për Shërbime Publike dhe
6. Komitetin për Pronë.

49.2 Kuvendi i Komunës, në kuadër të kompetencave që ka, miraton Rregulloren për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve.

Kryetari i Komunës

Neni 50

50.1 Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës që kanë të drejtë vote, në përputhje me Ligjin për zgjedhjet lokale që është në fuqi, për mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.

50.2 Kur përkohësisht mungon kryetari i Komunës, ose kur përkohësisht nuk ka mundësi ta ushtrojë funksionin e kryetarit, atë e zëvendëson nënkryetari i Komunës.

Betimi

Neni 51

51.1 Me rastin e zgjedhjes, kryetari i Komunës bën betimin përpara anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Përmbajtja e betimit është si vijon:

“Unë _____, betohem se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i Komunës së Prishtinës, me nder, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë.”

51.2 Nëse Kryetari i Komunës nuk e bën betimin brenda një (1) muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, e humb mandatin.

Kompetencat dhe Përgjegjësitë

Neni 52

Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e LVL - së dhe Statutit të Komunës, është përgjegjës të:

- a) përfaqësojë Komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) udhëheqë ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyrë administrimin financiar të Komunës;
- c) ushtrojë të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
- d) ekzekutojë aktet e Kuvendit të Komunës;
- e) emërojë dhe shkarkojë zëvendësin e tij/saj;
- f) emërojë dhe shkarkojë drejtorët, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g) organizojë punën dhe të drejtojë politikën e Komunës;
- h) propozojë rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
- i) propozojë zhvillimin komunal, planet rregulluese dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) raportojë para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike – financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku një herë në gjashtë muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës;
- k) kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsiderohet se akti bie në kundërshtim me legjislacionin në zbatimin, apo interesin e komuniteteve;
- l) mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm financiar;

- m) delegojë përgjegjësi te anëtarët e Këshillit të Drejtorëve dhe të mbikëqyrë zbatimin e përgjegjësi të deleguara;
- n) të bëjë ndryshime në lidhje me funksionimin dhe numrin e drejtorive dhe funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe
- o) të kryejë përgjegjësi të tjera të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës.

Aktet e Kryetarit të Komunës

Neni 53

Kryetari i Komunës merr vendime dhe lëshon urdhëresa brenda fushës dhe kompetencave të tij.

Nënkryetari i Komunës

Neni 54

54.1 Nënkryetari emërohet nga Kryetari i Komunës, për të njëjtin mandat, dhe shkarkohet nga Kryetari.

54.2 Me kërkesë të Kryetarit, nënkryetari i ndihmon Kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe, në mungesë të tij, vepron në emër të Kryetarit

54.3 Kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, Kryetari emëron nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

Shkarkimi nga posti dhe zgjedhja e kryetarit të ri të Komunës

Neni 55

55.1 Kryetari i Komunës mund të shkarkohet në pajtim me dispozitat e nenit 64 të LVL -së.

55.2 Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit, zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës mbahen pa vonesë.

ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 56

56.1 Administrata komunale organizohet në drejtori. Secila drejtori komunale udhëhiqet nga drejtori. Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës.

56.2 Komuna e Prishtinës do t'i ketë këto drejtori:

1. Drejtorja e Administratës;
2. Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
3. Drejtorja e Arsimit
4. Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
5. Drejtorja e Financave dhe Pronës;
6. Drejtorja e Ekonomisë dhe Zhvillimit;
7. Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
8. Drejtorja e Infrastrukturës Lokale;
9. Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
10. Drejtorja e Kadastrit;
11. Drejtorja e Inspektionit.

56.3 Organizimi i brendshëm i drejtorive dhe sistemimi i shërbyesve civilë në vende të punës, do të bëhet në bazë të Vendimit për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në drejtoritë e Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Drejtorëve

Neni 57

57.1 Këshilli i Drejtorëve përbëhet nga drejtorët e emëruar nga Kryetari i Komunës.

57.2 Secili anëtar i Këshillit të Drejtorëve:

- a) i raporton rregullisht Kryetarit për çështjet që janë në përgjegjësinë e tij;
- b) ndihmon Kryetarin, kryesuesin e Kuvendit të Komunës dhe komitetet e tij, duke iu ofruar të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;
- c) zbaton të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- d) përgatit programin e punës dhe prezanton raportet periodike të punës për drejtorinë e tij;
- e) është përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollin e përditshëm të punës së drejtorisë;
- f) përgatit dhe prezanton planet periodike të zhvillimit në sferën e tyre të përgjegjësisë dhe përcjelljen e këtyre planeve;
- g) përgjigjet në mënyrë efektive për çfarëdo ankese lidhur me sferën e vet të përgjegjësisë;
- h) merr pjesë dhe kontribuon në punën e Kuvendit të Komunës, të komiteteve përkatëse dhe në punën e Këshillit të Drejtorëve;
- i) siguron se do të ofrojë një qasje të drejtë dhe të barabartë për ato shërbime publike që janë në përgjegjësinë e tij;
- j) përmbush të gjitha detyrat dhe urdhëresat që i caktohen në mënyrë adekuate.

Neni 58

Zyrtarët e lartë, duke përjashtuar drejtorët e drejtorive, mund të largohen nga organet e Administratës sipas Ligjit për shërbimin civil.

Shërbimi civil komunal

Neni 59

59.1 Personeli administrativ përbën Shërbimin civil komunal, i cili udhëhiqet në pajtim me ligjin në fuqi për shërbimin civil në Kosovë.

59.2 Në Shërbimin civil komunal kushtet do të jenë të atilla, që lejojnë përzgjedhjen e personelit në bazë të kualifikimit dhe përvojës. Ky objektivi duhet të arrihet duke u dhënë përparësi kandidatëve me kualifikim dhe përvojë të duhur, duke u ofruar mundësi trajnimi pas punësimit dhe perspektivë për karrierë.

59.3 Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit. Kushtet për shpallje, rekrutim, largim, plotësim të vendit të punës, nëse posti i udhëheqësit të personelit mbetet i zbrazët dhe afati për rekrutimin e udhëheqësit të ri janë paraparë në nenin 66 të LVL – së.

59.4 Secila drejtori duhet të përpikët të sigurojë balancën në barazinë gjinore, në të gjitha fushat dhe nivelet në Shërbimin civil komunal.

59.5 Shërbimi civil komunal i kryen detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë korrekte dhe të paanshme, duke vepruar në pajtim me ligjin.

59.6 Punësimi i personelit në Shërbimin civil komunal bëhet përmes konkursit publik.

59.7 Të gjithë nëpunësit e Shërbimit civil komunal i përfillin dhe i zbatojnë urdhrat e eprorëve të tyre, përveç në ato raste kur urdhrat e tyre janë në kundërshtim me ligjin ose me të drejtat dhe liritë e njeriut.

59.8 Nga të gjithë nëpunësit civilë kërkohet që të gjitha konfliktet e interesit t'i paraqesin me shkrim në një regjistër, të cilin e ruan udhëheqësi i personelit.

Zyra e Komuniteteve

Neni 60

60.1 Zyra e komuniteteve formohet me qëllim të përmirësimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe të sigurimit të shërbimeve të barabarta publike në nivel komunal.

60.2 Zyra e komuniteteve është pjesë përbërëse e Komunës dhe e strukturës së përbashkët administrative, e cila financohet nga buxheti i Komunës.

60.3 Zyra e komuniteteve drejtohet nga një drejtues, i cili, sipas detyrës zyrtare, merr pjesë në takimet e Këshillit të Drejtorëve. Ai paraqet raportin në secilën mbledhje të Komitetit të Komuniteteve, duke përshkruar në detaje punët e kryera për të cilat është përgjegjëse ajo zyrë.

60.4 Personeli i Zyrës së komuniteteve gëzon status të personelit të shërbimit civil të Komunës.

KAPITULLI V

Administrimi financiar

Buxheti i Komunës

Neni 61

61.1 Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e saj, Komuna ka buxhetin e saj (buxheti i Komunës).

61.2 Buxheti i Komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kritere objektive.

61.3 Buxheti i Komunës duhet të përmbajë planin për aktivitetet dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal, dhe duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe ato të përditshme të Komunës. Ai gjithashtu duhet t'i ndajë fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të Komunës.

Të hyrat nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë

Neni 62

62.1 Qeveria, përmes Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, bën transferime financiare për komunat, duke u bazuar në kriteret objektive, përfshirë edhe vlerësimin e nevojave dhe burimeve financiare për Komunë.

62.2 Një pjesë e këtyre fondeve të transferuara, mund të ndahet për veprimtari të caktuara specifike. Komuna mund të pranojë grante operative nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK). Grantet operative janë: (i) grantet e përgjithshme, (ii) grantet specifike për Arsim dhe grantet specifike për shëndetësi.

62.3 Komuna duhet të njoftohet për shumën e fondit të transferuar për vitin e ri fiskal, në përputhje me Ligjin për financat e pushtetit lokal.

Të hyrat vetjake të Komunës

Neni 63

Komuna, në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore, krijon të hyra vetjake nga:

- a) tatimi në pronën e paluajtshme;
- b) taksat për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste;
- c) taksat për lejen për shërbime profesionale;
- d) taksat për automjete motorike;
- e) taksat administrative komunale;
- f) taksat e lejeve për ndërtimin dhe rrënimin e ndërtesave dhe strukturave të tjera;
- g) taksa të tjera komunale;
- h) taksa për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare;
- i) tarifatat për zhvillimin ose ruajtjen e infrastrukturës;
- j) gjobat në trafik;
- k) gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale;
- l) të hyrat nga qiradhënia;
- m) bashkëpagesat për arsim dhe shëndetësi.

Të hyrat tjera

Të hyrat nga donatorët

Neni 64

64.1 Për ta ndihmuar zhvillimin e Komunës, donatorët mund të derdhin mjetet në buxhetin e Komunës.

64.2 Nëse donatorët derdhin mjete në buxhetin e Komunës me destinim të caktuar, ato mjete nuk mund të përdoren për qëllime të tjera.

64.3 Donatorët kanë të drejtë të informohen për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i kanë derdhur në buxhetin e Komunës.

Të hyrat nga vetëkontributi

Neni 65

Për t'i përmbushur më mirë, apo për t'i përmirësuar nevojat e banorëve të saj, Komuna mund të sigurojë mjete edhe përmes deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, në pajtim me ligjet në fuqi. Mjetet e siguruar në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen vetëm për atë qëllim që janë deklaruar qytetarët. Mënyra e deklarimit dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me vetëkontributin, më hollësisht definojnë me ligj dhe me vendim për dhënien e vetëkontributit.

Neni 66

66.1 Komuna ka në dispozicion, në mënyrë të pavarur, të hyrat që i takojnë.

66.2 Për mënyrën e përdorimit të mjeteve, Kuvendi i Komunës duhet të vendosë në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 67

Buxheti i Komunës miratohet për një vit fiskal. Viti fiskal fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Huamarrja komunale

Neni 68

Huamarrja nga komunat rregullohet në bazë të dispozitave të Ligjit për financat e pushtetit lokal dhe Ligjit për borxhe publike.

KAPITULLI VI

Raporti vjetor

Neni 69

69.1 Kuvendi i Komunës miraton raportin vjetor të Kryetarit të Komunës pas propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, më së largu deri më 31 mars të vitit vijues.

69.2 Raporti përbëhet nga këto pjesë: titulli, hyrja, metodologjia, rezultatet, konkluzionet, rekomandimet, anekset dhe bibliografia.

Ndërmarrjet publike lokale

Neni 70

70.1 Ndërmarrjet publike lokale janë të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike.

70.2 Komuna të drejtën e saj si aksionare në NPL, do ta ushtrojë përmes Komisionit Komunal të Aksionarëve.

70.3 Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës, në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.

70.4 Komisioni Komunal i Aksionarëve i raporton Kuvendit të Komunës, për çdo vit, për të arriturat e ndërmarrjeve publike.

KAPITULLI VII

Auditori i brendshëm

Neni 71

Auditori i brendshëm është i autorizuar dhe ka përgjegjësi në pajtim me dispozitat e Ligjit për auditim të brendshëm,

KAPITULLI VIII

Konflikti i interesave

Neni 72

72.1 Kryetari, nënkryetari, kryesuesi, zëvendëskryesuesi për komunitete dhe anëtarët e Këshillit të Drejtorëve, përjashtohen nga procedurat lidhur me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me cilëndo çështje, në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal apo financiar.

72.2 Kur ndonjëri nga anëtarët e Këshillit të Drejtorëve ka konflikt interesi, Kryetari cakton rolin e tij që ka të bëjë me çështjen e caktuar, që ky rol të ushtrohet nga vet ai (ajo), ose nga drejtori që vepron në mbikëqyrjen e tij (saj) e që nuk ka konflikt interesi.

72.3 Përfundimi nga procedurat e marrjes së vendimeve të zyrtarëve të përmendur, mund të bëhet me tërheqjen e tyre vullnetare, me vendim të Kryetarit të Komunës, ose me kërkesë të palës së tretë.

KAPITULLI IX

Dispozitat përfundimtare

Neni 73

73.1 Ky Statut do të plotësohet dhe do të ndryshohet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

73.2 Të gjitha dispozitat e Statutit duhet të jenë në harmoni me dispozitat e LVL - së. Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij Statuti dhe dispozitave të LVL - së, atëherë vlejnë dispozitat e LVL - së.

Neni 74

74.1 Ky Statut hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në tabelën e shpalljeve të Komunës.

74.2 Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, pushojnë të vlejnë dispozitat e Statutit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 – 455, të dt. 31.3.2008.

Neni 75

Harmonizimi i të gjitha rregulloreve të Komunës dhe akteve tjera komunale me këtë Statut, duhet të bëhet në afat prej 6 muajsh nga dita e miratimit të këtij Statuti.

Neni 76

Interpretimi autentik i këtij Statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 110-391, më 25.2.2010

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Sami Hamiti, ecc. i dipl.